

# ANEKSI 24

## INTERPRETIMI STATISTIKOR I VERIFIKIMEVE

Një sasi e caktuar e zgjedhur në formë rastësore , prej sasisë totale të matësve elektrik që parashikohet të livrohen sipas kontratave të blerjes, do të nënshtrohen testimit me qëllim verifikimi. Përzgjedhja e matësve që do të testohen do të jetë rastësore si pjesë e shumës së dorëzuar. Zgjedhja e mostrave për testimin verifikues kryhet nga Operatori i Rrjetit kurse shërbimi i verifikimit për këtë qëllim kryhet nga subjektet e autorizuara / akredituara.

Procedurat e vlerësimit të konformitetit përcaktohen në MID-Measuring Instruments Directive (2004/22/EC) si edhe ISO 2859.

Procedura e marrjes së mostrave dhe interpretimi i tyre do të bëhet në bazë të Standardit IEC ISO 2859, duke përdorur kriterin që sistemi i testimeve të matësve të zgjedhur si provë duhet të garantojë një nivel cilësie pranimit (AQL) prej jo më shumë se 1%; (AQL është përqindja maksimale e artikujve të papajtueshëm në një lot, ku loti ka 95% probabilitet për t'u pranuar).

Rezultatet e provës do të jenë interpretime sipas ISO 2859-1:1999/Cor 1:2001 "Procedurat e marrjes së kampionëve për inspektim sipas veçorive - Pjesa 1: Skemat e marrjes së kampionëve të indeksuar sipas limit të cilësisë së pranimit (AQL) për kontrollin lot pas loti".

Kostoja e verifikimit nga subjektet e pavarur do të paguhet nga ofruesi drejtpërdrejt tek subjekti i pavarur.

Operatori i Rrjetit do të sjellë për testim nga loti i matësve të dorëzuar nga furnizuesi për të kryer teste me qëllim verifikimi një sasi të zgjedhur prej sasisë totale të dorëzuar.

**Tab. Nr.1**

Numri i matësve elektrik që janë livruar	Numri i matësve elektrik që do të verifikohen	AQL 1%	
		Pranohet	Refuzohet
2 deri 8	2	0	1
9 deri 15	2	0	1
16 deri 25	3	0	1
26 deri 50	5	0	1
51 deri 90	5	0	1
91 deri 150	8	0	1
151 deri 280	13	0	1
281 deri 500	20	0	1
501 deri 1200	32	1	2
1201 deri 3200	50	1	2
3201 deri 10 000	80	2	3
10 001 deri 35 000	125	3	4
35 001 deri 150 000	200	5	6
150 001 deri 500 000	315	7	8
500 001 dhe më shumë	500	10	11

**a. Kur sasia e matësave të cilat nuk kualifikohen është brenda normave Tab. Nr. 1**

Nëse numri i matësave elektrik që do të rezultojnë jo të përshtatshëm (nuk do të kualifikohen nga testimi verifikues, pra janë refuzuar) është i barabartë ose më i vogël se numri i pranuar sipas tabelës. Nr.1, atëherë e gjithë sasia e matësave të livruar do të konsiderohet si e pranueshme.

Matësat elektrikë që nuk do të kualifikohen gjatë testimit verifikues si më sipër, do t'i rikthen furnizuesit dhe ai do t'i zëvendësojë të gjithë matësat me dëmtime me shpenzimet e tij. Matësat elektrikë që do zëvendësohen do ti nënshtrohen testimit verifikues individual të plotë sipas sasisë që nuk u kualifikua në verifikimin e mëparshëm.

**b. Kur sasia e matësave të cilat nuk kualifikohen është jashtë normave Tab. Nr. 1**

Nëse numri i matësave elektrik që do të rezultojnë jo të përshtatshëm (nuk do të kualifikohen nga testimi verifikues, pra janë refuzuar) është më i madh se numri i pranuar sipas tabelës Nr.1, atëherë e gjithë sasia e matësave të livruar do të konsiderohet si jo e pranueshme.

**c. Shpenzimet e verifikimit dhe mos zgjidhjes së mos kualifikimeve**

- Kostoja e verifikimit nga subjektet e pavarur do të paguhet nga ofruesi drejtpërdrejt tek subjekti i pavarur.
- Të gjitha shpenzimet që lidhen me rikthimin e sasisë që nuk është pranuar (a) apo edhe të gjithë sasisë së livruar (b) mbulohen nga furnizuesi.